# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475414**

VERSIONI 2

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Maliqit voton kundër "shkrirjes" me Korçën - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/keshilli-bashkiak-i-maliqit-voton-kunder-shkrirjes-me-korcen/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 08:20:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 08:16:39 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `4e3e908415c7c2a7bfcfdf5503c51d34449ed477f36076669975912ca12384be` |
| TEKSTI | `96150a1238a8539aa16a1ab161bad27264fe1ad25e56273c86ac1f82d1660285` |
| PAMJA | `0c36e625e139ed569d4f02d9d0f80b3a18e7f19ca47d5c9b508adaf12909d858` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `639928aa7d83f86f12c7f61e0fa0d0b5ac932c8d53dc1fc7922e2e12943bc721` |
| E MËPARSHMJA | `1fd5ade16cb9886095ed2a3c27d951ea6ecf76a506deba62614dc2092963b700` |
| RRËNJA MERKLE | `b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/639928aa7d83f86f12c7f61e0fa0d0b5ac932c8d53dc1fc7922e2e12943bc721`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET | VENDI

# Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Maliqit voton kundër “shkrirjes” me Korçën

28 Shtator 2026 | 10:16

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Këshilli Bashkiak i Maliqit është mbledhur ditën e sotme për të diskutuar dhe më pas për të votuar projektvendimin për draftin e Reformës Territoriale. Mbledhja ka bërë bashkë të majtë e të djathtë, të cilët në unanimitet kanë votuar kundër këtij drafti. Sipas raportimeve, 21 anëtarë kanë votuar kundër bashkimit, ndërsa vetëm një ka votuar pro.

Ky votim kundër vjen pas mbledhjes së fundit, ku këshilltarët e majtë braktisën mbledhjen, me pretendimin se u nevojitej kohë për t’u njohur me draftin. Në atë mbledhje nuk pati vendimmarrje.

Këtë herë, këshilltarët e majtë kanë votuar kundër, duke shprehur qëndrimin se një bashkim i tillë nuk është në favor të banorëve dhe territorit të Bashkisë Maliq.

Votimi vjen edhe pas vizitës së kryeministrit Edi Rama në Korçë disa javë më parë, ku u diskutua drafti i Reformës Territoriale.

Ndërkohë, edhe banorë të Maliqit, si dhe eksponentë të ndryshëm të politikës lokale dhe përfaqësues të administratës, janë shprehur publikisht kundër kësaj reforme dhe shkrirjes së Maliqit me Korçën.

Në anën tjetër, disa ditë më parë, Këshilli Bashkiak i Korçës votoi pro këtij drafti dhe bashkimit me Maliqin.

**Shiko në:**

## LAJMI I FUNDIT

10:21 **Kallas: Rusia po planifikon akte sabotimi, duhen më shumë anije në Detin e Kuq**

10:20 **Drejtësia refuzoi tryezën e Ramës, vjen përgjigjia e Kryeministrisë**

10:09 **Brohoritje për Ratko Mlladiç në Marakana, pamjet nga ndeshja Serbi-Holandë shkaktojnë reagime**

10:08 **Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare**

10:06 **Zhvillohen tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen 3 persona për armëmbajtje, kultivim të narkotikëve dhe vjedhje**

10:04 **Zbuloi transferimin sekret të dy ushtarëve koreano-veriorë, Koreja e Jugut i kërkon llogari Ukrainës: Kërkoni falje**

TESTIM

## LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

### Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

Këshilli i Sigurisë Kombëtare, i thirrur nga Presidenti Bajram Begaj, ka përfunduar mbledhjen e zhvilluar këtë të hënë në Pallatin e Brigadave. Takimi nisi në...

10:08 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### Zhvillohen tre operacione në Tropojë e Kukës, arrestohen 3 persona për armëmbajtje, kultivim të narkotikëve dhe vjedhje

Tre persona janë vënë në pranga këtë të hënë, pas tre operacioneve të ndryshme të zhvilluara në Tropojë dhe Kukës, pasi akuzohen për veprat penale...

10:06 | 28/09/2026

AKTUALITET | VENDI

### GJKKO refuzon tryezën e Ramës për pagat e magjistratëve: Presim vendimin e Kushtetueses

Edhe Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO) nuk do të marrë pjesë në tryezën konsultative të thirrur nga kryeministri Edi Rama...

09:51 | 28/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.